<p>ritestohet dhe nuk ka të drejtë të vazhdojë në fazat tjera të testimit.</p> <p>5. Kandidati që ka ndonjë vërejtje në procesin e rekrutimit dhe seleksionimit për çdo fazë të testimit ka të drejtë të ankohe. Ankesa duhet t'i adresohet Komisionit përzgjedhës në afatin prej 5 ditësh, nga dita e publikimit të rezultateve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 17 Testimi me shkrim</p> <p>1. Testimi me shkrim për zyrtarët policorë, përbëhet prej 100 pyetjeve dhe koha e testimit zgjat 2 orë e 30 minuta.</p> <p>1.1. Testimi është i dizajnuar që t'i testojë kandidatët në këto fusha: 40 % në fushën e njohurive të përgjithshme; 30% gjuhë dhe letërsi dhe 30% matematikë. Rezultati minimal i kërkuar për ta kaluar me sukses testin është 70% të përgjigjeve nga testi.</p> <p>2. Testimi me shkrim për stafin civil përbëhet prej 30-50 pyetjeve dhe koha e testimit zgjat 1 orë e 30 minuta.</p> <p>2.1. Testimi është i dizajnuar që t'i</p>	<p>nema pravo da nastavi u ostalim fazama testiranja.</p> <p>5. Kandidat koji ima primedbu na proces regrutovanja i selekcije za svaku fazu testiranja ima pravo na žalbu. Žalba se adresira izbornoj komisiji u roku od 5 dana od dana objavljivanja rezultata.</p> <p style="text-align: center;">Član 17 Pismeno testiranje</p> <p>1. Pismeno testiranje za policijske službenike sastoji se od 100 pitanja i vreme trajanja testiranja je 2 sata i 30 minuta.</p> <p>1.1. Testiranje je dizajnirano da testira kandidate u sledećim oblastima: 40 % iz oblasti opštih saznanja; 30% jezika i književnosti i 30% matematike. Minimalni zahtevani rezultat da bi uspešno položio test je 70% odgovora iz testa.</p> <p>2. Pismeno testiranje za civilno osoblje sastoji se od 30-50 pitanja i vreme testiranja traje 1 sat i 30 minuta.</p> <p>2.1. Testiranje je dizajnirano da testira</p>	<p>and to continue in other testing phases.</p> <p>5. The candidate who has any remark in the recruitment and selection process for any testing phase has the right of appeal. The appeal should be addressed to Selection Committee within 5 days, from the day of publishing results.</p> <p style="text-align: center;">Article 17 Written test</p> <p>1. Written test for police officers is consisted of 100 questions and the testing time is 2 hours and 30 minutes long.</p> <p>1.1. The test is designed to test candidates in the following fields: 40 % in the field of general knowledge; 30% language and literature and 30% mathematics. Minimal result to pass the test successfully is 70% of answers from the test.</p> <p>2. The written test for civilian staff is consisted of 30-50 questions and testing time is 1 hour and 30 minutes.</p> <p>2.1. The test is designed to test</p>
---	--	--



<p>testojë kandidatët në këto fusha: 60 % në fushën e njohurive nga pozita për të cilin aplikon dhe 40% nga fusha e njohurive të përgjithshme.</p> <p>2.2. Rezultati minimal i kërkuar për ta kaluar me sukses testin është 70% të përgjigjeve nga testi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 18 Testimi i shkathtësive fizike</p> <p>1. Standardet e testimit të shkathtësive fizike duhet të jenë të përshkruara në formularin, respektivisht në broshurën e shkathtësive fizike.</p> <p>2. Gjatë procesit të testimit të shkathtësive fizike përveç Komisionit-panelit duhet të jetë prezent edhe zyrtari mjekësor nga Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore, i cili para se kandidati t'i nënshtrohet testimit të aftësive fizike, në praninë e Komisionit vlerësues do ta pyesë kandidatin për gjendjen e tij shëndetësore dhe se a është i gatshëm që t'i nënshtrohet këtij testi.</p> <p>3. Nëse kandidati deklaron se është në gjendje të mirë shëndetësore dhe është i</p>	<p>kandidate u sledećim oblastima: 60 % iz oblasti saznanja iz položaja gde je konkurisao i 40% iz oblsti opštih saznanja.</p> <p>2.2. Minimalni zahtevani rezultat da se test uspešano polaže je 70% odgovora iz testa.</p> <p style="text-align: center;">Član 18 Testiranje fizičke sposobnosti</p> <p>1. Standardi testiranja fizičke sposobnosti treba da su opisane na obrascu, odnosno u brošuri fizičkih sposobnosti.</p> <p>2. Tokom procesa testiranja fizičkih sposobnosti, osim komisije-panela treba da je prisutan i lekarski službenik od strane Direkcije zdravstvenih službi, koji će, pre nego što se kandidat podvrgava testiranju fizičke sposobnosti i u prisustvu ocenjujuće komisije, pitaće kandidata o njegovom zdravstvenom stanju i da li je spreman da se podvrgava ovom testiranju.</p> <p>3. Ukoliko kandidat izjavljuje da je u dobrom zdravstvenom stanju i da je</p>	<p>candidates in the following fields: 60 % in the field of the applying position and 40% from the general knowledge.</p> <p>2.2. Minimal score required to successfully pass the test is 70% of answers from the test.</p> <p style="text-align: center;">Article 18 Physical skills test</p> <p>1. The standards of the physical skills test should be described in the form, respectively in the physical skills brochure.</p> <p>2. During the process of physical skills test except the Committee-panel, medical officer from the Directorate of Medical Health should be present also, who before the candidate is subject of physical skills test, in the presence of the evaluation Committee will ask the candidate for his health condition and if he is ready to undertake the test.</p> <p>3. If the candidate declares that he is in a good health condition and is ready to be</p>
---	---	---



<p>gatshëm t'i nënshtrohet testit të shkathtësive fizike, nga ai do të kërkohet që ta plotësojë dhe nënshkruajë formularin mbi lirimin nga përgjegjësia dhe dëmshpërblimi, nëse atij gjatë këtij procesi i shkaktohet ndonjë problem shëndetësor apo lëndim fizik.</p> <p>4. Vlerësimi i rezultatit të testit fizik bëhet duke përcaktuar në mënyrë të qartë se kandidati ka kaluar apo ka dështuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 19 Intervista me gojë</p> <p>1. Me rastin e intervistimit me gojë, kandidati vlerësohet në: mënyrën e paraqitjes dhe prezantimit, aftësisë komunikuese, njohurive të përgjithshme, aftësisë për të analizuar, vendimmarrja, motivimi, përkushtimi dhe vetëbesimi. Intervista me gojë për secilin kandidat zhvillohet në intervalin kohor prej minimum 30 minuta.</p> <p>2. Kandidati duhet të arrijë së paku një rezultat prej 70% nga poenat e mundshme për të vazhduar më tutje me procesin e konkurrimit.</p>	<p>spreman da se podvrgava testiranju fizičkog testiranja, od njega će se zahtevati da papuni i potpiše obrazac o oslobodjivanja odgovornosti i nadoknade, ukoliko se njemu u toku procesa prouzrokuje neki zdravstveni problem ili fizika povreda.</p> <p>4. Ocenjivanje rezultata fizičkog testa vrši se jasno odredjujući da li je kandidat položio ili ne.</p> <p style="text-align: center;">Član 19 Usmeni intervju</p> <p>1. Prilikom usmenog intervjuisanja, kandidat se ocenjuje: o načinu predavljenja i prezantiranja, komunicirajuće sposobnosti, opšteg saznanja, sposobnosti za analiziranje, odlučivanja, motivacije, posvećivanja i samouverenosti. Usmeni intervju za svakog kandidata odvija se u vremenskom intervalu minimalno od 30 minuta.</p> <p>2. Kandidat treba da postigne najmanje rezultata od 70% od mogućih bodova da bi dalje produžio process konkurisanja.</p>	<p>subjected to the physical skills test, he will be asked to fill in and sign in the form on the release from the responsibility and compensation, if during this process he is caused any health problems or physical injury.</p> <p>4. Evaluation of the physical test results is done by clearly deciding if the candidate passed or failed.</p> <p style="text-align: center;">Article 19 Interview</p> <p>1. In the case of interview, the candidate is evaluated in: way of presentation and appearance, communicating skills, general knowledge, ability to analyze, decision making, motivation, commitment and self-confidence. The interview for each candidate is performed at the period of minimum 30 minutes.</p> <p>2. The candidate should achieve at least a result of 70% of the maximum points to continue further with the competition process.</p>
---	--	--



Neni 20 Testimi psikologjik	Član 20 Psihološko testiranje	Article 20 Psychological test
<p>1. Kriteret për testim psikologjik përcaktohen nga Drejtoria e Personelit dhe Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore ndërsa mbahet nga institucioni shëndetësor i licencuar dhe i kontraktuar nga Policia.</p> <p>2. Lidhur me rezultatet e testit psikologjik, respektivisht lidhur me atë se kandidati i plotëson apo nuk i plotëson kushtet për seleksionim, duhet të shqyrtohen dhe të vlerësohen nga një psikolog. Pas vlerësimit dhe konkludimit në formë të shkruar psikologu ia dërgon Drejtorisë për Shërbime Shëndetësore konstatimin mbi atë se kandidati e kalon me sukses apo dështon në testin psikologjik.</p> <p>3. Të gjitha rezultatet dhe vlerësimet e testit psikologjik duhet të mbahen konfidenciale.</p> <p>4. Kandidatët të cilët dështojnë në testimin psikologjik kanë të drejtë ankese në komisionin përzgjedhës, brenda 3 ditëve të punës pas publikimit të rezultateve.</p>	<p>1. Kriterijumi za psihološko testiranje odredjuju se od strane Direkcije za osoblje i Direkcije zdravstvenih službi dok se održava od strane zdravstvene institucije licenciran i ugovoren od Policije.</p> <p>2. U vezi rezultata psihološkog testa, odnosno u vezi toga da li kandidat ispunjava ili ne ispunjava uslove za selekciju, treba da se razmatraju i ocenjuju od strane jednog psihologa. Nakon ocenjivanja i zaključivanja u pismenoj formi psiholog dostavi Direkciji zdravstvene službe utvrđivanje o tome da je kandidat uspešno ili neuspešno završio psihološki test.</p> <p>3. Svi rezultati i ocenjivanja psihološkog testa treba da se drže u tajnosti.</p> <p>4. Kandidati koji ne uspevaju u psihološkom testu imaju pravo žalbe u izornoj komisiji, u roku od tri radnih dana nakon objavljivanja rezultata.</p>	<p>1. The criteria for psychological test are determined by Directorate of Personnel and Directorate of Health Services while they are held by the health institution licensed and contracted by Police.</p> <p>2. About the results of psychological test, respectively about whether the candidate meets or does not meet the criteria for selection, it should be reviewed and evaluated by a psychologist. After evaluation and conclusion in paper, the psychologist submits to the Directorate of Health Services the conclusion on whether the candidate passes successfully or fails in the psychological test.</p> <p>3. All the results and evaluations of psychological tests should be kept confidential.</p> <p>4. The candidates that fail in psychological test have the right on appeal at the selection commission, within 3 days after publishing the results.</p>



Neni 21
Kontrolli mjekësor

1. Departamenti i Burimeve Njerëzore është përgjegjës për informimin e kandidatëve të suksesshëm për kontrollin mjekësor lidhur me vendin, datën dhe kohën e mbajtjes së kontrollit mjekësor si dhe bën informimin e kandidatëve të cilët kanë dështuar në testimin psikologjik.

2. Kontrolli mjekësor mbahet në institucionin e licencuar shëndetësor të kontraktuar nga Policia.

3. Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore kërkon nga institucioni i kontraktuar ta plotësojë kartelën mjekësore në të cilën janë të përcaktuara të gjitha llojet e ekzaminimeve mjekësore.

4. Institucioni i licencuar shëndetësor i kontraktuar është i obliguar që pas përfundimit të kontrollit mjekësor t'i dërgojë kartelat mjekësore për secilin kandidat në Drejtorinë e Shërbimeve Shëndetësore për t'i dërguar në Drejtorinë e Personelit për procedurë të mëtejshme si në vazhdim:

Član 21
Lekarska kontrola

1. Uprava ljudskih resursa je odgovorna za informiranje uspešnih kandidata za lekarsku kontrolu u vezi mesta, datuma, i vremena održavanja lekarske kontrole kao i vrši informiranje kandidata koji nisu uspevali na psihološkom testiranju.

2. Lekarska kontrola održava se u licenciranoj zdravstvenoj instituciji ugovorene od strane Policije.

3. Direkcija zdravstvene službe zahteva od ugovorene institucije da papuni zdravstveni karton gde su određene sve vrste lekarskog egzaminiranja.

4. Licencirana i ugovorena lekarska institucija dužna je da nakon okončanja lekarske kontrole da dostavi zdravstvene kartone, za svakog kandidata, u Direkciji zdravstvene službe da bi dostavila u Direkciji za osoblje za sledeći dalji postupak:

Article 21
Medical examination

1. Department of Human Resources is responsible for informing successful candidates for medical examination about the location, date and time of medical examination and also notifies the candidates that failed in psychological test.

2. Medical examination is held at the licensed health institution contracted by Police.

3. Directorate of Health Services asks from the contracted institution to fill the medical card in which there are determined all types of medical examinations.

4. The licensed health institution contracted by Police after completing examinations is obliged to send medical cards to the Department of Human Resources for every candidate at the Directorate of Health Services in order to send them at the Directorate of Personnel for the further procedure as follows:



<p>4.1. Rezultatet mjekësore publikohen duke përcaktuar në mënyrë të qartë se kandidati “ka kaluar” apo “ka dështuar” në kontrollin mjekësor.</p> <p>4.2. Pas publikimit të rezultateve kartela mjekësore vendoset në dosjen personale të kandidatëve.</p> <p>4.3. Rekomandime profesionale mjekësore që parashihet në kartelë mjekësore, gjithmonë duhet të cekën problemet shëndetësore apo sëmundja që është pengesë për kandidatin që ta kryejë me sukses punën për të cilin ka konkurruar.</p> <p>5. Kandidatët të cilët dështojnë në kontrollin mjekësor kanë të drejtë ankese në Komisionin përzgjedhës, brenda 3 ditëve të punës pas publikimit të rezultateve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 22 Shpallja e rezultateve</p> <p>1. Divizioni i Personelit dhe Administratës është përgjegjës për shpalljen e rezultateve të çdo faze të</p>	<p>4.1. Lekarski rezultati objavljuju se, jasno utvrđujući da je kandidat “uspeo” ili “nije uspeo” na lekarskoj kontroli.</p> <p>4.2. Nakon objavljivanja rezultata, zdravstveni karton postavi se u lični dosije kandidata.</p> <p>4.3. Profesionalne lekarske preporuke koje se predviđaju na zdravstvenom kartonu, uvek treba da se navedu zdravstveni problemi ili bolest koji je smetnja za kandidata da uspešno izvršava posao za koji je konkurisao.</p> <p>5. Kandidati koji neuspevaju na lekarsku kontrolu imaju pravo žalbe Izornoj komisiji u roku od tri radnih dana nakon objavljivanja rezultata.</p> <p style="text-align: center;">Član 22 Objavljivanje rezultata</p> <p>1. Divizija za osoblje i administraciju je odgovorna za objavljivanje rezultata svake faze testiranja.</p>	<p>4.1. Medical examinations are published stating clearly that the candidate “has passed” or “has failed” in the medical examination.</p> <p>4.2. After publication of results the medical card is placed in the personal candidate file.</p> <p>4.3. Professional medical recommendations that are foreseen in the medical card, should always be stated the health problem or illness that is an obstacle for the candidate to perform successfully work for which has applied.</p> <p>5. The candidates that fail in the medical examination have the right in appeal at the selecting Committee, within 3 working days after publishing results.</p> <p style="text-align: center;">Article 22 Announcing the results</p> <p>1. Division of Personnel and Administration is responsible for announcing results for each testing phase.</p>
--	---	---



<p>testimit.</p> <p>2. Regjistri i rezultateve meritore përfshin rezultatin e dy fazave të testimeve. Renditja e kandidatëve bëhet sipas meritës, dhe atë sipas kësaj kronologjie: rezultati nga testi me shkrim i kandidatit vlerësohet me 60% dhe vlerësimi i testit-intervistës gojore 40%.</p> <p>3. Bazuar në nevojat e Policisë për plotësimin me zyrtarë policorë dhe pozitave specifike për staf civil, nga lista e ranguar sipas meritës, kandidatët thirren për t'iu nënshtruar testimit psikologjik dhe kontrollit mjekësor.</p> <p>4. Pas përfundimit të testit psikologjik dhe mjekësor bëhet shpallja e rezultateve të kandidatëve.</p>	<p>2. Registar zaslužnih rezultata obuhvata rezultat dve faze testiranja. Redosled kandidata vrši se prema zasluge i to prema sledeće hronologije: rezultat iz pismenog testa kandidata ocenjuje se sa 60% pismenog testa i ocenjivanje usmenog testa-intervijua 40% opšteg rezultata.</p> <p>3. Na osnovu potreba Policije za popunjavanje sa policijskim službenicima i specifične položaje civilnim osobljem, od rangirane liste prema zasluzi, kandidati se pozivaju da se podvrgavaju psihološkom testiranju i lekarske kontrole.</p> <p>4. Nakon okončanja psihološkog i lekarskog testa vrši se objavljivanje rezultata kandidata.</p>	<p>2. The final meritorious results register contains final result of two testing phases. Ranking of candidates is done based on merits, and according to this chronology: result from written test is evaluated 60% of written test and evaluation of interview 40%.</p> <p>3. Based on the Police needs for staffing with police officers and specific positions for civilian staff, from the list ranked based on merits, the candidates are called to undergo psychological test and medical examination.</p> <p>4. After completion of psychological and medical test, announcement of candidate results is done.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 23 Verifikimi i të së kaluarës</p> <p>1. Pas publikimit të rezultatit meritor dhe rezultateve nga testi psikologjik dhe mjekësor, Sektori i Rekrutimit dhe Seleksionimit, listën e kandidatëve të cilët duhet të vijojnë kursin themelor për policinë e përgjithshme (trajnimin bazik) ia dërgon Drejtorisë së Standardeve</p>	<p style="text-align: center;">Član 23 Proveravanje prošlosti</p> <p>1. Nakon objavljivanja zaslužnog rezultata iz psihološkog i lekarskog testa, Sektor za regrutovanje i selekciju, listu kandidata koji treba da pohađaju osnovi kurs za opštu policiju (bazičnu obuku) za policajce, dostavi Direkciji profesionalnih standarda za proveravanje prošlosti.</p>	<p style="text-align: center;">Article 23 Background verification</p> <p>1. After publishing final meritorious result and results from the psychological and medical tests the Section of Recruitment and Selection, sends the list of candidates who have to attend basic course for general police (basic training) for police to the Directorate of Professional Standards for</p>



<p>Profesionale për verifikim të së kaluarës.</p> <p>2. Pas përfundimit të verifikimit mbi të kaluarën, Drejtoria e Standardeve Profesionale aplikacionet me rezultatin e verifikimeve të kryera për secilin kandidat me rekomandim ia kthen Sektorit të Rekrutimit dhe Seleksionimit, e cila pastaj këto rezultate i vendos në bazën e të dhënave të Sektorit të Rekrutimit dhe Seleksionimit.</p> <p>3. Sektori i Rekrutimit dhe Seleksionimit publikon listën përfundimtare të rezultateve finale e cila ka vlefshmërinë dy (2) vite për kandidatët për zyrtarët policorë. Rezultati minimal i kërkuar që kandidati të jetë në listën e rezultateve finale është 70%. Varësisht nga nevojat e Policisë së Kosovës për zyrtar policor kandidatët do të ftohen sipas renditjes meritore në listën e publikuar të rezultateve finale.</p> <p>4. Nëse kandidati gjatë verifikimit mbi të kaluarën dështon, nuk do të ketë mundësi të punësohet në Polici.</p> <p>5. Lista e kandidatëve të suksesshëm të cilët ftohen për nënshkrimin e kontratës për punësim duhet të dërgohet 10 ditë para</p>	<p>2. Nakon okončanja proveravanja prošlosti, Direkcija profesionalnih standarda, prijave sa rezultatima izvršenih proveravanja za svakog kandidata sa preporukom vrati Sektoru za regrutovanje i selekciju, koja će zatim ove rezultate postaviti na bazi podataka Sektora za regrutovanje i selekciju.</p> <p>3. Sektor Regrutacije i selektiranja objavljuje konačnu listu finalnih rezultata koja ima važnost dve (2) godine za kandidate policijskih službenika. Minimalan zahtevani rezultat da bi kandidat bio na listi finalnih rezultata je 70%. Zavisno od potreba Policije Kosova za policijske službenike kandidati se pozivaju prema zasluženom redosledu u objavljenoj listi finalnih rezultata.</p> <p>4. Ukoliko kandidat tokom proveravanja prošlosti neuspeva, neće imati mogućnosti da se zaposli u Policiji.</p> <p>5. Lista uspešnih kandidata koji se pozivaju za potpisivanje radnog ugovora treba da se dostave 10 dana pre početka</p>	<p>background verification.</p> <p>2. After completing background verification, the Directorate of Professional Standards sends the applications of completed verifications for each candidate by recommendation back to the Section of Recruitment and Selection, which decides for results based on the data of Section of Recruitment and Selection.</p> <p>3. The Section of Recruitment and Selection publishes the final list of final results that is valid for two (2) years for the candidates for police officers. The minimal result required for the candidate to enter the list of final results is 70%. Depending on the Kosovo Police needs for police officers, candidates will be invited according to the order of merit in final published list.</p> <p>4. If the candidate fails during background verification, he will not be able to be employed in Police.</p> <p>5. The list of successful candidates invited to sign in the contract of employment should be sent 10 days before the</p>
---	---	--



fillimit të trajnimit në Divizionin e Trajnimeve i cili është përgjegjës për organizimin, mbajtjen dhe zhvillimin e trajnimit.

Neni 24
Kontrata për punësim për zyrtarë policorë

1. Kandidatët para se ta vijojnë kursin themelor për polic lidhin kontratë të punës. Nëse i punësuari nuk e fillon kursin themelor për policinë e përgjithshme brenda tri ditëve, atëherë marrëdhënia e punës nuk do të krijohet, sepse do të konsiderohet se kandidati është tërhequr.

2. Pas nënshkrimit të kontratës për punësim, kandidati i dorëzohet ftesa për vijimin e kursit themelor për policinë e përgjithshme në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, i cili realizohet nga personeli policor i Divizionit të Trajnimeve.

3. Kandidati i cili e kryen me sukses kursin themelor, gjatë ceremonisë së certifikimit duhet ta japë betimin konform dispozitave të parapara me ligj, e pastaj certifikohet si zyrtar policor me gradën

obuke u Diviziji za obuku koja je odgovorna za organizovanje i razvoj obuke

Član 24
Ugovor o zaposlenju za policijske službenike

1. Kandidati pre nego što pohađaju osnovni kurs za policajce zaključuje radni ugovor. Ukoliko zaposleni ne počinje osnovnu obuku za opštu policiju u roku od tri dana, onda neće se stvoriti radni odnos, jer će se smatrati da se kandidat povukao.

2. Nakon potpisivanja ugovora za zaposlenje, kandidatu se predaje poziv za pohađanje osnovnog kursa za opštu policiju u Kosovskoj Akademiji za javnu bezbednost, koji će se ostvariti od policijskog osoblja Divizije za obuku.

3. Kandidat koji uspešno završava osnovni kurs, tokom ceremonije certifikacije, treba da daje zakletvu shodno odredbama predviđenih zakonom, zatim se certifikuje kao policijski službenik činom "novi

beginning of training at the Division of Training responsible for organization, conducting and development of training.

Article 24
Contract for employment of police officers

1. Candidates prior to attending basic course for police sign in a work contract. If the employee does not start the basic course for general police, then the work relation will not be established, because it will be considered that the candidate gave up.

2. After signing a work contract, invitation to attend basic course for general police at the Kosovo Academy of Public Safety is sent to the candidate, realized by police personnel of the Training Division.

3. The candidate who successfully completes the basic course, during the certification ceremony should oath conform provisions foreseen by law, then they certified as a police officer with a rank



<p>“Polic i ri” dhe i caktohet vendi i punës.</p> <p>3.1. Pas kryerjes së kursit themelor për policinë e përgjithshme dhe certifikimit të kandidatit “Polic i ri” kandidati duhet ta kryejë trajnimin fushor në kohëzgjatje prej 24 muajsh.</p> <p>3.2. Nëse kandidati nuk e kryen me sukses kursin themelor për policinë e përgjithshme, atëherë atij i ndërpritet marrëdhënia e punës në Polici.</p> <p>3.3. Nëse gjatë trajnimit fushor performanca e punonjësit policor është e pakënaqshme atëherë atij do t’i ndërpritet marrëdhënia e punës në Polici.</p> <p>4. Derisa i punësuarit është duke e vijuar kursin themelor për policinë e përgjithshme dhe duke e kryer trajnimin fushor i realizon të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës sikur të punësuarit e tjerë në Polici.</p>	<p>policajac” i odredjuje mu se radno mesto.</p> <p>3.1. Nakon završetka osnovnog kursa za opštu policiju i certifikovanja kandidata za “novog policajca” kandidat treba da završi terensku obuku u trajanju od 24 meseci.</p> <p>3.2. ukoliko kandidat ne završi uspešno osnovni kurs opšte policije, onda se njemu prekida radni odnos u Policiji.</p> <p>3.3. Ukoliko tokom terenske obuke performansa policijskog radnika je nezadovoljavajuća onda se njemu prekida radni odnos u Policiji.</p> <p>4. Dok zaposleni je u toku pohađanja osnovnog kursa za opštu policiju za policajce u Kosovskoj Akademiji za javnu bezbednost i pohađajući terensku obuku, ostvaruje sva prava i obaveze radnog odnosa kao drugi zaposleni u Policiju.</p>	<p>of “New Police” and a work position is appointed.</p> <p>3.1. After completing the basic course for general police and certification of candidate as a “new Police”, candidate should complete field training for the period of 12 months.</p> <p>3.2. If the candidate does not complete successfully the basic training for general police, then his work relation in Police is terminated.</p> <p>3.3. If during the field training, performance of police employee is unsatisfactory then work relation in Police will be terminated.</p> <p>4. While the employee is attending basic course of general police and while performing field training, enjoys all the benefits and obligations from the work relation same as other Police employees.</p>
--	---	---



Neni 25 Kontrata për punësimin e stafit civil	Član 25 Ugovor za zaposlenje civilnog osoblja	Article 25 Contract for employment of civil staff
<p>1. Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit dhe përzgjedhjes së kandidatit për punësim në cilësinë e stafit civil lidhet kontrata e punësimit, me të cilën i punësuarit krijon marrëdhënie pune në Policinë e Kosovës. Në kontratë të punësuarit i caktohet vendi i punës dhe data kur duhet të fillojë punën.</p> <p>2. Nëse i punësuarit nuk e fillon punën me datën e përcaktuar me kontratë, atëherë marrëdhëniet e punës nuk do të krijohet, sepse do të konsiderohet se kandidati është tërhequr, përveç nëse me arsye është penguar që ta fillojë punën.</p> <p>3. Kontrata e punës mund të lidhet për:</p> <ul style="list-style-type: none">3.1. periudhë të pacaktuar kohore;3.2. periudhë të caktuar kohore dhe3.3. për punë dhe detyra specifike. <p>4. Kontrata e punës në të cilën nuk ceket kohëzgjatja e punësimit, konsiderohet si kontratë pune në periudhë të pacaktuar.</p> <p>5. Të gjithë kandidatët e punësuar në</p>	<p>1. Nakon okončanja postupka regrutovanja i izbora kandidata za zaposlenje u svojstvu civilnog osoblja, zaključuje se radni ugovor kojim zaposleni stvara radni odnos u Policiji Kosova. Ugovorom se zaposleniku određuje radno mesto i datum kada počinje da radi.</p> <p>2. Ukoliko zaposlenik ne počinje da radi određenog datuma ugovorom, onda se radni odnos ne stvori, jer će se smatrati da kandidat se povlačio, osim ako je opravdano sprečavan da dolazi na posao.</p> <p>3. Radni ugovor se zaključuje za:</p> <ul style="list-style-type: none">3.1. neodređeni vremenski period;3.2. određeni vremenski period, i3.3. za rad i specifične dužnosti. <p>4. Radni ugovor u kojem se ne navodi vremensko trajanje zaposlenja, smatra se radnim ugovorom na neodređeno vreme.</p> <p>5. Svi zaposleni kandidati na određeno</p>	<p>1. After completing recruitment procedure and selection of the candidates for employment in the quality of civil staff, employment contract is signed, by which the employee establishes work relation with Kosovo Police. In the contract it is determined a working position and date of starting work.</p> <p>2. If the employee does not start work on the date stated in contract, then work relation will not be established, because it will be considered that the candidate gave up, except if with any reason he was hindered to start the job.</p> <p>3. The work contract can be signed for:</p> <ul style="list-style-type: none">3.1. Undetermined period of time;3.2. Determined period of time and3.3. Specific works and duties. <p>4. The work contract in which employment period is not stated is considered as a working contract for undetermined period of time.</p> <p>5. All the candidates employed for</p>



<p>afat të caktuar kohor (pozitat të jo karrierës) pranohen në punë provuese në kohëzgjatje prej tre (3) muajsh, në pritje të konfirmimit pas një vlerësimi pozitiv të kryerjes së detyrës.</p> <p>6. Kalimi i nëpunësit nga punësimi me afat të caktuar në pozitë në afat të pacaktuar kohor bëhet vetëm nëse shpallet pozita e lirë për atë vend pune dhe nëse përzgjidhet.</p> <p>7. Kontrata për detyra specifike nuk mund të jetë më e gjatë se 120 (njëqindnjëzet) ditë brenda një viti.</p>	<p>vreme (ne karijerni položaji) primaju se na probni rad u vremenskom trajanju od tri (3) meseca, na čekanju utvrđivanja nakon pozitivnog ocenjivanja vršenja dužnosti.</p> <p>6. Prelaz službenika od zaposlenja u određenom roku na položaju neodređenog roka vrši se samo ako se objavi slobodan položaj za to radno mesto i ukoliko se radnik izabere.</p> <p>7. Ugovor za specifične dužnosti ne može biti duži od 120 (sto dvadeset) dana u toku godine.</p>	<p>determined period of time (non carrier positions) are accepted in probation work in period of three (3) months, waiting for confirmation after positive evaluation of work performance.</p> <p>6. Transfer of the employee from a determined period employment in the undetermined period position is done only if an open vacancy is announced for that position and if the employee is selected.</p> <p>7. Contract for specific works cannot be longer than 120 (one hundred and twenty) days within the year.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 26 Themelimi i marrëdhënies së punës në kohë të caktuar</p>	<p style="text-align: center;">Član 26 Zasnjivanje radnog odnosa na određeno vreme</p>	<p style="text-align: center;">Article 26 Establishing work relation for determined period of time</p>
<p>1. Themelimi i marrëdhënies së punës në kohë të caktuar bëhet në rastet dhe kushtet si në vijim:</p> <p>a) Kur kryerja e një pune të caktuar zgjat për një kohë të caktuar, por jo më gjatë se nëntë (9) muaj të vitit kalendarik (punë sezonale);</p> <p>b) Kur përkohësisht rritet vëllimi i punës që nuk mund të zgjasë më</p>	<p>1. Zasnjivanje radnog odnosa na određeno vreme vrši se u sledećim slučajevima i uslovima:</p> <p>a) Kada vršenje nekog određenog posla traje određeno vreme, ali ne duže od devet (9) meseci kalendarike godine (sezonski rad);</p> <p>b) Kada privremeno povećava obim rada koji ne može trajati više od 6</p>	<p>1. Establishing work relation for determined period of time is done in following cases and conditions:</p> <p>a) When completion of work takes certain period of time, but not longer than nine (9) months of the calendar year (seasonal work);</p> <p>b) When the level of work is increased temporarily that cannot</p>



<p>tepër se 6 muaj;</p> <p>c) Kur zëvendësohet punëtori i cili përkohësisht mungon;</p> <p>2. Punëtori i cili ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të caktuar, marrëdhënia e punës i ndërpritet në këto raste: kur të kryhen punët, kur t'i kalojë afati i caktuar ose ditën e kthimit të punëtorit i cili ka munguar.</p> <p>3. Plotësimi i vendeve të punës në kohë të caktuar duhet të publikohet përmes shpalljes publike.</p> <p style="text-align: center;">Neni 27 Periudha provuese për punonjësit e stafit civil</p> <p>1. I punësuarit në Polici në cilësinë e punonjësit të stafit civil në fazën e punës provuese i realizon të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës konform dispozitave të këtij udhëzimi administrativ.</p> <p>2. Të punësuarit e stafit civil që pranohen në Polici në kohë të pacaktuar emërohen në punë provuese në kohëzgjatje deri në dymbëdhjetë muaj.</p>	<p>meseci;</p> <p>c) Kada se zamenjuje radnik koji privremeno odsustvuje;</p> <p>2. Radnik koji je zasnivao radni odnos na određeno vreme, radni odnos mu se prekida na sledećim slučajevima: kada se završavaju poslovi, kada ističe određeni rok ili danom povratka radnika koji je odsustvovao.</p> <p>3. Popunjavanje radnih mesta na određeno vreme treba da se objavi putem javnog oglasa.</p> <p style="text-align: center;">Član 27 Probni period za radnike civilnog osoblja</p> <p>1. Zaposleni u Policiju u svojstvu civilnog osoblja u fazi probnog rada ostvaruje sva prava i obaveze iz radnog odnosa shodno odredaba ovog Administrativnog uputstva.</p> <p>2. Zaposleni civilnog osoblja koji se primaju u Policiji na neodređeno vreme, imenuju se na probni rad u vremenskom trajanju od dvanaest meseci.</p>	<p>last more than 6 months;</p> <p>c) When temporary absent worker is replaced;</p> <p>2. Worker who established work relation for determined period of time, work relation is terminated in these cases: when works are completed, when period of time is done or in the day of returning of absent worker.</p> <p>3. Filling work positions for certain period of time should be published through the public announcement.</p> <p style="text-align: center;">Article 27 Probation period for civil staff employee</p> <p>1. Employee in Police in the quality of civil staff employee in the probation phase enjoys all the rights and obligations from the work relation in accordance with administrative instruction.</p> <p>2. Civil staff employee who is accepted in Police in undetermined period of time is appointed for probation work in duration of twelve months.</p>
--	---	--



<p>3. Në përfundim të periudhës provuese, në bazë të vlerësimit pozitiv të performancës, eprori i drejtpërdrejtë i punonjësit, mbështetur në rezultatet në punë dërgon informacionin te Drejtoria e Personelit për procedurë të mëtejme. Nëse performanca është e pakënaqshme, Drejtoria e Personelit bazuar në procedurat e punës e mban të drejtën që t'ia ndërpresë marrëdhënien e punës punonjësit në punë provuese.</p> <p>4. Në rastet e pushimeve si pushimi vjetor, pushimi i lehonisë, pushimi mjekësor dhe në raste tjera të veçanta, puna provuese zgjatet për aq kohë sa është bërë ndërprerja e punës provuese.</p> <p>5. Puna provuese nuk aplikohet për punonjësit të cilët janë punësuar në një pozitë nëpërmjet ngritjes në karrierë.</p>	<p>3. Krajem probnog perioda, na osnovu pozitivnog ocenjivanja performanse, neposredni starešina radnika, osnovajući se na radnim rezultatima dostavlja informaciju kod Direktora za osoblje za dalji postupak. U koliko performansa je nezadovoljna, Direkcija za osoblje na osnovu radnih procedura snosi pravo da mu prekine radni odnos radnika na probnom radu.</p> <p>4. Uslučajevima odmora ili godišnjeg odmora, kao porodiljsko odsustvo, bolovanje i u drugim posebnim slučajevima, probni rad se produži za toliko vremena koliko je trajalo prekid probnog rada.</p> <p>5. Probni rad se ne primenjuje za radnike koji su zaposleni u neki položaj preko unapredjenja u karijeri.</p>	<p>3. In the end of probation period, based on the positive evaluation of performance, immediate supervisor of employee, based on work results sends information at the Directorate of Personnel for further procedure. If the performance is unsatisfactory, Department of Personnel based on the work procedures has the right to terminate work relation of a probation employee.</p> <p>4. In cases of annual leaves, maternity leave, medical leave and in other special cases, probation work is extended for the interrupted period of time.</p> <p>5. Probation work is not applied for the employees that are employed in a position through carrier advancing.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 28 Kartela identifikuese</p> <p>1. I gjithë personeli policor duhet të pajiset me kartelë identifikuese, në të cilën duhet të jetë fotografia, të dhënat personale të punonjësit, si dhe të dhëna</p>	<p style="text-align: center;">Član 28 Identifikovana kartica</p> <p>1. Celo policijsko osoblje treba da se otprema sa identifikovanom karticom, u kojem treba da je slika, lični podaci radnika kao i drugi podaci. Radnici su</p>	<p style="text-align: center;">Article 28 Identification Card</p> <p>1. The entire police personnel should be equipped with identification card, in which should be picture, personal data of employee, and other data. Employees are</p>



<p>tjera. Punonjësit janë të obliguar që gjatë orarit të punës, respektivisht gjatë qëndrimit në objektet e Policisë të bartin kartelën identifikuese.</p> <p>2. Departamenti i Burimeve Njerëzore është i obliguar që një kopje të KI-së, kontratën e punës dhe numrin e llogarisë bankare të punonjësit ta dërgojë në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe një kopje në Drejtorinë e Logjistikës së Policisë.</p> <p>3. Kartela identifikuese përmban të gjitha elementet e sigurisë.</p> <p>4. Dizajni dhe të gjitha elementet e sigurisë së kartelës identifikuese aprovohen nga drejtori i përgjithshëm i Policisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 29 Kompletimi dhe ruajtja e aplikacioneve</p> <p>Drejtoria e Personelit pas përmbylljes së procesit të rekrutimit të kandidatëve për kadet policor/staf civil brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve e bën kompletimin e dosjeve të kandidatëve të cilët janë duke e vijuar trajnimin themelor për policinë e përgjithshme, dhe të njëjtat dërgohen në</p>	<p>obavezni da tokom radnog vremena, odnosno tokom boravka u objektu Policije, nose identifikovanu karticu.</p> <p>2. Uprava ljudskih izvora je obavezna da po jedan primerak IK, radnog ugovora i broja bankarskog računa radnika dostavi Direkciji za budžet i financije i jedan primerak Direkciji za Logistiku Policije.</p> <p>3. Identifikovana kartica sadrži sve elemente bezbednosti.</p> <p>4. Dizajn i svi elementi bezbednosti identifikovane kartice usvajaju se od strane Generalnog Direktora Policije.</p> <p style="text-align: center;">Član 29 Kompletiranje i čuvanje prijave</p> <p>Direkcija za osoblje, nakon okončanja procesa regrutiranja kandidata za policijske pitomce/civilno osoblje u roku od 15 (petnaest) dana vrši kompletiranje dosijea kandidata koji pohađaju osnovnu obuku za opštu policiju, i iste se dostavljaju u dosje Osoblja. Prijave ili dosijei kandidata</p>	<p>obliged that during working hours, respectively during presence at the Police facilities, wear identification card.</p> <p>2. Department of human Resources is obliged that a copy of ID, work contract and bank account number of the employee send at the Directorate of Budget and Finances and a copy to the Directorate of Police Logistic.</p> <p>3. Identification card contains all safety elements.</p> <p>4. Design and safety elements of identification card are approved by the general director of Police.</p> <p style="text-align: center;">Article 29 Completion and storage of applications</p> <p>Directorate of Personnel, after completing the recruitment process of candidates for police cadets/civil staff within 15 (fifteen) days does the completion of candidates dossiers who are attending basic training for general police, and the same are sent to the Personnel dossier, while applications or</p>
--	---	---



dosjet e Personelit. Aplikacionet apo dosjet e kandidatëve të cilët janë në pritje vendosen-mbeten në arkivin e Divizionit të Personelit dhe Administratës, ndërsa aplikacionet joaktive (aplikacionet e kandidatëve të cilët kanë dështuar) ruhen sipas aktit të brendshëm për ruajtjen dhe arkivimin dokumenteve.

Neni 30
Kalimi prej zyrtarit policor në staf civil

1. Zyrtarët policorë kanë të drejtë të konkurrojnë vetëm në pozitë deficitare (ekspert në fushën përkatëse) ku me strukturë organizative parashihet të jetë staf civil, përfshirë edhe pozitën e larta drejtuese, me kusht që këta t'i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara me konkurs të brendshëm.

2. Me rastin e kalimit të zyrtarit policor në punonjës të stafit civil zyrtarit policor i pushojnë të gjitha autorizimet dhe beneficionet të cilat i kanë takuar si zyrtar policor.

3. Nëse nga personeli ekzistues i Policisë, përfshirë punonjësit e stafit civil dhe punonjësit me autorizime policore, ka

koji su na çekanju postavlja/ostaju u Arhivi Divizije za osoblje i administraciju, dok neaktivne prijave (prijave kandidata koji nisu uspevali) čuvaju se prema unutrašnjeg akta za čuvanje i arhiviranje dokumenata.

Član 30
Prelazak iz policijskog osoblja na civilno osoblje

1. Policijski službenici imaju pravo da konkurišu samo na deficitarnom položaju (stručnjak iz dotične oblasti), gde organizativnom strukturom se predviđa da je civilno osoblje obuhvatajući i visoke upravne položaje, pod uslovom da ovi ispunjavaju uslove i kriterijume određene unutrašnjem konkursu.

2. Prilikom prelaska policijskog službenika na radnika civilnog osoblja, policijskom službeniku prestaju sva ovlašćenja i beneficije koje je imao kao policijski službenik.

3. Ukoliko od postojećeg osoblja Policije, obuhvatajući civilne radnike i radnike sa policijskim ovlašćenjima, ima kandidata

dossiers of the candidates that are on waiting list are placed-remain at the Division of Personnel and Administration archive, while inactive applications (application of failed candidates) are stored according to the internal act on storing and archiving documents.

Article 30
Transfer from police officer to civil staff

1. Police officers have right to apply only in deficient positions (experts in certain fields) where it by the organizational structure is foreseen civilian staff, including higher leading positions, with condition that they meet competition determined criteria.

2. In the case of transfer of police officer into civil staff, police officer's authorizations and benefits that enjoyed as police officer, cease.

3. If from the existing Police personnel, including civilian staff and employees with police authorizations, there are candidates



<p>kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet e parapara për plotësimin e vendeve të lira të punës, përfshirë edhe pozitat e larta drejtuese, atëherë shpallet konkursi i brendshëm, ku kandidatët e interesuar mund të konkurrojnë dhe pas procedurës së konkurrimit të bëhet përzgjedhja e kandidatit.</p> <p>4. Nëse nga personeli ekzistues i Policisë nuk ka kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet për pozita të larta drejtuese, apo nëse gjatë procesit të rekrutimit kandidatët të cilët kanë konkurruar kanë rezultuar të papërshtatshëm, atëherë mund të shpallet konkursi publik, ku kandidatët e interesuar mund të konkurrojnë dhe pas procedurës së konkurrimit dhe rekrutimit të bëhet përzgjedhja e kandidatit.</p> <p>5. Të gjithë zyrtarët policorë të cilët ndërrojnë statusin nga zyrtarët policor në staf civil, sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të rikthehen në statusin e zyrtarit policor.</p> <p style="text-align: center;">Neni 31 Rregullat e punës</p> <p>1. Personeli i Policisë duhet të paraqitet</p>	<p>koji ispunjavaju predvidjene uslove za ispunjavanje slobodnih radnih mesta, obuhvatajući i visoka mesta upravljanja, onda se raspisuje unutrašnji konkurs, gde zainteresovani kandidati mogu konkurisati i nakon postupka konkurisanja vrši se izbor kandidata.</p> <p>4. Ukoliko od postojećeg osoblja Policije, nema kandidata koji ispunjavaju uslove za visoke pozicije upravljanja, ili ukoliko tokom procesa regrutovanja kandidati koji su se prijavili su se pokazivali neprikladnim, može se raspisivati javni konkurs, gde zainteresovani kandidati mogu da konkurišu i nakon procedure konkurisanja i regrutovanja vrši se izbor kandidata</p> <p>5. Svi policijski službenici koji izmene status od policijskih službenika na civilno osoblje, shodno stava 1 ovog člana, nemaju pravo da se vrate na status policijskog službenika.</p> <p style="text-align: center;">Član 31 Radna pravila</p> <p>1. Osoblj Policije treba da se javi na</p>	<p>who meet criteria foreseen for filling vacant positions, including high leading positions, than an internal competition is opened, where interested candidate can apply and after applying procedure, selection of candidate is done.</p> <p>4. If from the existing police personnel there are no candidates who meet the requirements for senior management positions, or if during the process of recruitment the candidates who have applied have proved to be inadequate, it may be declared public competition, where interested candidates can compete and after the procedure of competition and recruitment, candidate will be selected.</p> <p>5. All police officers who change their status from police officers into civilian staff, according to paragraph 1 of this article, have no right to return in the status of police officer.</p> <p style="text-align: center;">Article 31 Working rules</p> <p>1. The Police Personnel should be</p>
---	--	--



